



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 4 tetor 2012

Numri i lëndës: 2012-02

Gani Zeka

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 4 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 1 mars 2012. Znj. Micheva-Ruseva është anëtare e Panelit dhe gjithashtu gjykatëse e EULEX-it. Ajo ka lëshuar aktgjykimin e shkallës së parë në lëndën e cila është temë e këtij vendimi. Prandaj znj. Micheva-Ruseva nuk mund të merr pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde si anëtare e Panelit. Ajo është zëvendësuar nga znj. Dominik, anëtare zëvendësuese.

II. FAKTET

Procedurat administrative

1. Parashtruesi i ankesës dhe vëllezërit e tij B.Z. dhe R.Z. janë bashkëpronarë të disa ngastrave të tokës në komunën e Lipjanit. Në vitin 2003 parashtruesi i ankesës i cili jeton jashtë Kosovës, ka autorizuar B.Z për ta përfaqësuar atë para autoriteteve të Kosovës.
2. Më 8 korrik 2005 R.Z. ka parashtruar një kërkesë në departamentin për planifikim dhe urbanizëm të komunës së Lipjanit për leje për ndërtimin e një hoteli në pronën e vëllezërve. Kjo kërkesë ishte miratuar më 7 gusht 2005. R.Z. në atë leje figuronte si investitor i vetëm.
3. Më 9 shkurt 2009 parashtruesi i ankesës dhe vëllai i tij B.Z. kanë kontestuar lejen pranë autoriteteve komunale të Lipjanit, duke kërkuar që të përfshihen si bashkë investitorë.
4. Komuna e Lipjanit ka miratuar kërkesën në disa raste. Sidoqoftë, këto vendime vazhdimisht ishin shfuqizuar nga ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Për momentin, procedurat administrative pranë ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor janë ende të pazgjidhura.

Procedurat pranë gjykatës komunale të Lipjanit

5. Më 12 mars 2009 parashtruesi i ankesës dhe vëllai i tij B.Z. kanë parashtruar një ankesë pranë gjykatës komunale të Lipjanit, duke kërkuar një deklaratë se së bashku me B.Z. ata janë bashkëpronarë të ndërtuesës së ndërtuar në pronën e tyre të përbashkët. Ata gjithashtu kanë kërkuar të vendosen masat e përkohshme ndaj të pandehurit.
6. Më 28 shtator 2009 gjykata ka lëshuar një masë të përkohshme dhe ka ndaluar R.Z. që ta tjetërsoj, fsheh, ta vë në obligim të drejtën mbi ndërtuesën apo tokën në fjalë.
7. Më 26 nëntor 2009, pas ankesës së paditësit, gjykata e qarkut në Prishtinë ka shfuqizuar vendimin dhe ka kthyer lëndën për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.
8. Më 21 korrik 2010 gjykata e qarkut në Lipjan prapë ka lëshuar një masë të përkohshme që të ndaloj R.Z. ta tjetërsoj, fsheh apo ta vë në obligim të drejtën mbi pronën deri në përfundim të procedurave gjyqësore.
9. Më 23 gusht gjykata e apelit prapë ka shfuqizuar vendimin dhe ka kthyer lëndën për rishqyrtim në gjykatën komunale.

10. Në bazë të vendimit të kryetarit të asamblesë së gjykatësve të EULEX-it të datës 16 shtator 2010, lënda i ishte caktuar një gjykatësi të EULEX-it për shqyrtim.
11. Më 1 dhjetor 2010 gjykata komunale e Lipjanit pjesërisht e kishte miratuar kërkesën e paditësit lidhur me masat e përkohshme, duke e ndaluar të paditurin që të tjetërsoj, fsheh apo vë në obligim të drejtën e pronës. Gjykata ka hedhur poshtë kërkesën e tyre për të ndaluar të paditurin që të shfrytëzoj pronën dhe t'i largoj rojet e sigurimit nga vendi.
12. Më 14 mars 2011 gjykata ka miratuar ankesën e parashtruar nga parashtruesi i ankesës dhe B.Z., ndërsa R.Z. kanë parashtruar një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në gjykatën e qarkut në Prishtinë.
13. Në një datë të mëvonshme të pacaktuar, parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga kryetari i asamblesë së gjykatësve të EULEX-it (kryetari) që ta caktoj lëndën tek një trup i gjykatësve të EULEX-it në mënyrë që të përshtypejtohen procedurat. Më 11 korrik 2011 kryetari ka hedhur poshtë kërkesën. Ai ka konstatuar se lënda nuk i përmbushte kërkesat sipas nenit 5.1 të ligjit të datës 13 mars 2008 mbi kompetencat, përgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi kompetencat). Në veçanti, nuk ka pasur ndonjë dyshim të bazuar rrëth përpjekjeve për të ndikuar në paanshmërinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor apo dyshimit se gjyqësori vendor nuk ishte i gatshëm apo ishte i paaftë që në mënyrë të duhur të merrej me lëndën, apo rrëth ndonjë shkelje të rëndë sa i përket paanësisë së procedurave. Më tej, kryetari ka konstatuar se thjesht pritshmëria që të vendoset rrëth lëndës sipas rendit të përparësisë përcaktuar në datën në të cilën lënda ishte parashtruar në gjykatë, nuk ishte e mjaftueshme për të arsyetuar caktimin e asaj lënde tek gjykatësit e EULEX-it në shkallën e apelit.
14. Në një datë të mëvonshme të pacaktuar, gjykatësi vendor i gjykatës së qarkut në Prishtinë ka kërkuar nga kryetari i asamblesë së gjykatësve të EULEX-it që lëndën ta caktoj tek një trup gjyques të përzier. Ajo pohoi se gjykata e ka shumë të vështirë që ta trajtoj lëndën dhe se përpjekjet e vazhdueshme të palëve që ta shtyjnë gjykatën të shqyrtoj lëndën e tyre ishin problematike dhe burim shqetësimi. Kryetari ka miratuar kërkesën më datën 10 maj 2012. Ai ka konstatuar se për t'iu shmangur çfarëdo forme të ndikimit në gjyqësorin vendor dhe në mënyrë që të zvogëlohen tensionet mes palëve, ishte e duhur dhe në interes të administrimit të drejtësisë që lënda të caktohej tek një gjykatës i EULEX-it në procedurën e apelit.
15. Këto procedura janë në pritje pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë.

III. ANKESAT

16. Parashtruesi i ankesës pohon se procedurat ishin të padrejta dhe të tej zgjatura duke shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa).
17. Më tej ai ankohet se sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës atij është duke iu mohuar e drejta e tij në qasjen dhe shfrytëzimin e pronës së tij.
18. Për më tepër, ai ankohet se lënda e tij pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë nuk është marrë përsipër dhe shqyrtaar nga trupi gjykues i përbërë nga gjykatës të EULEX-it. Ai përmend nenin 7 (një e drejtë e cila duhet të mbrohet me ligj) të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (Deklarata).

IV. LIGJI

19. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
20. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
21. Sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Paneli tashmë ka konstatuar se edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykatë të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera, lëndët nga PShDNj nr. 2011-24, *Predrag Lazić*, § 20; 2011-10, *Dejan Jovanović*, § 33.).
22. Paneli vijon se ankesat që kanë të bëjnë e procedurat që ende janë në pritje pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë dalin jashtë mandatit të Panelit. Pra, Paneli konstaton se kërkesa e parashtruesit të ankesës ishte miratuar dhe se lënda ishte marrë përsipër nga një trup gjykues i përzier i përbërë gjithashtu nga gjykatës të EULEX-it.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se ankesa është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese